



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.108/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada –Glllogjani anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të vendosjes së banerave mbi rrugët publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, ashtu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,700.00 (njëmijë e shtatqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Me datën 06.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga koalicioni PDK-AAK-NISMA me të cilën pretendon se me datën 06.06.2017 diku rreth orës 11: 50 në rrugën Tahir Sinani në qytetin e Shtimes, aktivistët e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Shtime kanë vendosur mbi rrugë publike banerin me kandidatët për deputet nga ky subjekt politik. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4paragrafi 1 pika b) i Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara nga vendi i ngjarjes.

Në përgjigje në ankesë të datës 07.06.2017, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) thekson se ka marrë masat përmisuese lidhur me këtë çështje duke e larguarbanerin ku ka qenë i vendosur ai, andaj personat që kanë vendosur banerin mbi rrugë publike nuk kanë qenë në dijeni se një veprim i tillë përbën shkelje të rregullave zgjedhore. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografi me të cilat dëshmohet heqja e banerit nga rruga publike ku ka qenë e vendosur ajo.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidateve për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) është vendosur mbi rrugë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugë publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që baneri i kandidatëve për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), është vendosur mbi rrugë publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti baneri i kandidatëve për deputet nga ky subjekt politik është i vendosur mbi rrugë publike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarr veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë larguar banerin nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.108/2017 më datën 07.06.2017.

Kryesuesi i Panelit

Zydi Haziri



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.